

AIS organizoi në datën 8 mars që është edhe dita ndërkombëtare e gruas një workshop / tryezë mbi Kontrata Publike me Qeverinë Vendore sipas Perspektivës Gjimore pjesë e projektit Monitoro Klient të Bashkive në Kontrata Publike, projekti i financuar nga Leviz Albania Demokracia Vendore në Veprim. Në këtë event u prezantuan gjetjet e analizës për periudhën korrik 2015 deri 30 janar 2017<sup>1</sup>. Pas prezantimit të gjetjeve dhe metodologjisë së evidentimit dhe vlerësimit u kërkuar mendim nga Moderator / Opinionit në çështje të statistikës mbi perspektivën gjimore; opsionit të kuotave për barazi dhe shanse të barabarta; vështirësi të bizneseve në procese prokurimi; fuqizim ekonomik të gruas etj. Moderatorët u përzgjodhën nga sektorë të ndryshëm si biznes; shoqëri civile; gazetari etj. Tryeza u shoqërua me diskutime dhe eksperiencë lokale dhe jo lokale mbi fuqizimin e gruas në ekonomi dhe mundësinë e gjenerimit të evidencave edhe më të detajuara në këtë kontekst. Mbi tryezën janë formuluar Konkluzione si vijon:

*Konkluzione dhe rekomandime të Tryezës data 8 mars, mbi Kontrata Publike me Qeverinë Vendore sipas Perspektivës Gjimore*

*Pjesëmarrja e gruas në biznes është shprehje e demokracisë dhe zbatimit të lirive dhe të drejtave të individit në një vend. Në këtë kontekst, hulumtimi i AIS mbi pjesëmarrjen e subjekteve private të zotëruara apo administruara nga gratë merr një interes të veçantë.*

*Në grupin e indikatorëve të studiuara nga AIS, mund të përmenden: përqindja e vlerës totale të kontratave të fituara nga subjekte të zotëruara apo administruara nga gratë; % e numrit të kontratave të fituara nga subjekte të zotëruara apo administruara nga gratë; % e eficiencës së tenderimit në kontratat e fituara nga subjekte të zotëruara apo administruara nga gratë, etj. Ajo që vihet re është një prani e ulët e subjekteve me pronësi femra apo të administruara prej tyre. Vetëm 3.2% e vlerës totale të kontratave janë lidhur me subjekte të zotëruara apo administruara nga gratë apo 5% e numrit të të gjithë kontratave, në një kohë që gratë zotërojnë rreth 30% të bizneseve në rang kombëtar. Akoma më keq paraqitet situata në administrimin e shoqërive aksionare në pronësi të Bashkive, ku vetëm 4 nga 107 sh.a. administrohen nga femra.*

*Analiza e realizuar nga AIS nxjerr në dukje bashki, të cilat kanë pasur kontrata të fituara nga subjektet private të zotëruara apo administruara nga gra, si: Cërriku, Elbasani, Tirana, Vlora apo Shkodra, etj, ndërkohë që janë shqetësuese bashki si: Fushë-Arrëz, Tepelena, Mati, Poliçani, Librazhdi, Devolli apo Libohova, në të cilat nuk ka as një kontratë të vetme të fituar nga subjekte private të zotëruara apo administruara nga gratë. Akoma më tej, në bizneset të zotëruara nga femrat, që kanë fituar kontrata publike me bashkitë, bie në sy që 44.85% e tyre janë biznes i vogël.*

*Të gjitha këto rezultate flasin për një prani të ulët të bizneseve të zotëruara nga femrat në përfitimin e parave publike. Interesant ngelet fakti që në rastin e kontratave të fituara nga subjektet e zotëruara nga gratë, eficienca në prokurim është më e lartë, 17% e fondit të fituar krahasuar me fondin limit, krahasuar me 13.5% që është në rastin e subjekteve të zotëruara nga meshkujt.*

*Për t'u vlerësuar është fakti që databaza e prezantuar nga AIS vjen në nivel kombëtar për të 61 bashkitë dhe të dhënat janë shumë përfaqësuese. Ajo rrit transparencën mbi përdorimin e*

---

<sup>1</sup> <http://ais.al/new/tryeze-pune-kontratat-publike-me-qeverine-vendore-sipas-perspektives-gjimore/>

fondeve publike dhe flet qartësisht mbi përfaqësimin e gruas në biznes dhe gruas në përfitimin e fondeve publike.

I. Disa nga hapat e sugjeruar, që mund të ndërmerren më tej për të rritur cilësinë e këtij informacioni dhe ndikimin e tij në vendimmarrje janë:

Duhet marrë në analizë shtrirja apo prania e bizneseve të zotëruara apo administruara nga gratë në ato bashki që nuk kanë asnjë kontratë të fituar nga subjekte të zotëruara apo administruara nga gratë si dhe lloji i veprimtarisë së ushtruar prej tyre. Ky informacion më pas, mund të ballafaqohet me gjetjet e hulumtimit, për të parë nëse ka hapësira për pjesëmarrje në procesin e tenderimit nga ana e tyre.

Për të rritur besueshmërinë e të dhënave, ato duhet të ndahen qartësisht apo “zhvishen” nga maskimi i “faktorit burrë”, tipike kjo e rasteve kur kalimi i zotërimit të kuotave të biznesit apo administrimit të tij drejt grave bëhet nga bashkëshortët për arsye politike. Analiza e të dhënave të këtyre biznese ndër vite, në një hark 3-4 vjeçar do të pasqyrojë më saktë qëndrueshmërinë e këtyre bizneseve, për të vlerësuar nëse edhe vlera 3.4% e kontratave publike të fituara nga subjekte të zotëruara nga gratë është real dhe nuk është pasojë e politikave dhe interesave të momentit, që fshehin ndikimet e elementit “burrë”.

Për të pasuruar analizën, do të ishte me vlerë të merren në shqyrtim numri i subjekteve të zotëruara apo administruara nga gratë, të cilat s’kualifikohen nga gara e tenderimit, si dhe numri apo vlera totale e kontratave me negociim, të thirrura nga bashkitë, në të cilat kanë munguar subjektet e zotëruara apo administruara nga gratë.

Do të ishte e këshillueshme të plotësohet analiza edhe me elementë të kërkimit cilësor, për të hulumtuar më tej në bashki që kanë një situatë më problematike me përfaqësimin e grave në përfitimin e fondeve publike, si: Tepelena, Mati, etj, por edhe të bashkive që shfaqin karakteristika të veçanta, si Cërriku apo Shkodra.

II. Hapa që mund të ndërmerren për rritjen e pjesëmarrjes së subjekteve të zotëruara apo administruara nga gratë në proces tenderimi dhe krijimi i hapësirave të barabarta në përfitimin e fondeve publike.

Të hulumtohet mbi shkaqet se pse subjektet e zotëruara apo administruara nga gratë nuk preferojnë të marrin pjesë në proces tenderimi.

Duhet të punohet për të ndryshuar profilin e grave që merren me biznes, për të kaluar nga biznes i vogël, drejt një profili më të lartë.

Të promovohen modelet pozitive të grave në biznes.

Të vlerësohen me indikatorë të qartë politikat e ndërmarra deri tani në mbështetje të grave dhe si kanë ndikuar ato në përfshirjen e grave në biznes. Një fokus të veçantë në këtë këndvështrim duhet të marrë vlerësimi i buxhetimit me bazë gjinore.

Hartimi i programeve me fokus të veçantë mbështetjen e bizneseve të zotëruara nga gratë.

Të ndërmerren anketime dhe studime, që ndihmojnë në vlerësimin e potencialeve ku gratë mund të merren me biznes apo identifikimin e këtyre veprimtarive.

Duhet rritur përfaqësimi i grave në ekipet drejtuese dhe bordet e Dhomave të Tregtisë.

Të përpilohet një dokument i qartë me hapat që duhet të ndiqen për të marrë pjesë në tenderim, shoqëruar me një fushatë sensibilizuese me fokus bizneset e zotëruara apo administruara nga gratë.

Të realizohen trajnime të grave në biznes mbi procedurat e tenderimit.

Të vlerësohen me shumë kujdes propozimet mbi hapat ligjor që mund të ndërmerren për procedura tenderimi me bazë gjinore, pa rrezikuar shtrembërimin e procesit apo krijimit të kushteve abuzuese në pjesëmarrje.